



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin

Nr. 62 Piat
23.07.2018

VENDIM

Nr. 50/L datë 13.07. 2018

Për

Miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “Uljal Energy” ,për shfrytëzimin e përroit të i“Qarrishtës”, degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC ARRËZ, për qëllime hidroenergjie.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 “Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore” neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d , neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Per miratimin e kushteve të pergjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërise, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”. Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Keshillit Kombëtare të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”,

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

VENDOSI:

Mos miratimin e kërkesës për marrje leje “Miratim në parim” subjektit “Uljal Energy” ,për shfrytëzimin e përroit të i“Qarrishtës”, degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Librazhd për ndërtimin e HEC ARRËZ, për qëllime hidroenergjie.

Kordinatat e marrjes së ujit.

X 44 48 685

Y 45 70 592

Z 626 m m.n.d

Prurja e llogaritur	0.36 m ³ /sek
Prurja mesatre	0.28 m ³ /sek
Prurja ekologjike	0.53 m ³ /sek

Kordinatat e pikës së shkarkimit :

X 44 46 549

Y 45 67 439

Z 440 m m.n.d

Prurja e shkarkimit 0.36 m³/sek.

Trupi uhor pritës

Lumi Rrapun

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do të jetë 500 kw.

Për përdorimin e këtij burimi uhor duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Të mos çënoj furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të perspektivës.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për cdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN

Dashamir BIÇAKU



KRYETARI I KBU

SHKUMBIN

Maksim MALAJ

